

Nuhi BYTYÇI

**KONTRIBUTI I GRAVE TË LLAPUSHËS GJATË LUFTËS
PËR LIRI DHE PAVARËSI, SI DHE NË NDËRTIMIN E
SHTETIT TË KOSOVËS**

Studimi hedh dritë mbi kontributin e grave të zonës së Llapushës gjatë luftës për liri dhe pavarësi, si dhe në ndërtimin e shtetit të Kosovës duke e përfshirë, rolin, kontributin dhe perspektivat e tyre, pra një analizë koncize dhe një vështrim më të plotë dhe të detajuar mbi zhvillimin historik dhe shoqëror që kanë dhënë vajzat dhe gratë e zonës së Llapushës. Gratë shqiptare në Kosovë kanë pasur një rol thelbësor në të gjitha proceset historike të popullit shqiptar. Përgjatë periudhave historike, gratë kanë qenë të përfshira aktivisht në të gjitha lëvizjet për liri dhe pavarësi. Ato kanë qenë më aktive duke kontribuar me guxim dhe përkushtim në ndryshimet që ka përjetuar shoqëria. Roli i tyre ka qenë thelbësor në përcaktimin e shtigjeve të lëvizjeve të ndryshme shoqërore, politike dhe kulturore, duke shërbyer si burime të frymëzimit dhe forcës së transformimit.

Në Demonstratat e pranverës së vitit 1981, nga rajoni i Llapushës, shumë gra kanë qenë në krye të aktiviteteve, duke përfshirë Xhevë Krasniqi-Lladrovcin, Hasime Mazrekun, Bahrije Kastrati-Besimin, Mira Kuçin, Zade Kelmendin, Xhylë Berishën dhe shumë të tjera. Pjesëmarrja e tyre aktive në këtë periudhë dhe në periudhat e mëvonshme tregon vendosmërinë dhe përkushtimin e tyre ndaj lëvizjes për liri dhe pavarësinë e Kosovës. Si gazetar korrespondent i luftës do të ofrojë dhe të dhëna për kontributin e grave të Llapushës gjatë luftës për liri dhe pavarësi si dhe në ndërtimin e shtetit të Kosovës. Gratë e këtij rajoni kanë qenë aktive në çdo fazë të luftës për të mbrojtur identitetin, gjuhën, kulturën dhe të drejtat e tyre themelore.

Ato kanë qenë pjesë e organizatave rezistente dhe kanë kontribuar në organizimin e aktiviteteve të lëvizjes për liri, duke shfaqur guxim dhe përkushtim në frontin e betejave, si dhe në strukturat e reja të shtetit që u krijuan pas pavarësisë së Kosovës. Roli i tyre ishte tejet i madh dhe pa dyshim që kanë lënë gjurmë në historinë e Kosovës.

Kontributi i grave të Llapushës gjatë luftës së Kosovës (1998-1999)

Lufta çlirimtare e popullit të Kosovës në vitet 1998-1999, e udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK), është një kapitull i lavdishëm në historinë kombëtare. Kjo luftë ishte e drejtë, e detyrueshme dhe e pashmangshme për të drejtat dhe lirinë e popullit shqiptar në Kosovë. Në këtë periudhë të vështirë, populli i Kosovës, u përballë me një regjim të dhunshëm e të padrejtë serb, i cili kreu masakra ndaj popullit shqiptar. Por me guxim dhe vendosmërinë e tyre të pandashme, luftëtarët e UÇK-së dhe populli i Kosovës rezistuan dhe luftuan dhe në fund përmbushën synimet e tyre për liri dhe pavarësi.¹ Gratë shqiptare të Kosovës ishin pjesë e pamohueshme e luftës së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kundër regjimit okupues serb gjatë viteve të luftës në 1998-1999.

Në këtë periudhë të vështirë, gratë e Kosovës kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm. Gratë e rajonit të Llapushës kanë luajtur një rol të rëndësishëm në këtë luftë. Ato kanë marrë pjesë aktivisht në shumicën e njësisive të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke shërbyer në vijat e frontit, si dhe në shërbime logjistike të rëndësishme, si përgatitja e ushqimit, veshmbathja për luftëtarët dhe trajtimi i plagëve të tyre. Përkushtimi dhe guximi i grave të Llapushës si dhe i grave të Kosovës në përgjithësi, kanë qenë shembulli më i lartë i solidaritetit dhe sakrificës për liri.² Në kuadër të Brigadës 121 dhe 122 të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që kanë vepruar në Zonën Operative të Pashtrikut, veçanërisht në komunën e Malishevës, gratë nga kjo trevë kanë qenë të përfshira në luftën për liri dhe pavarësi krah për krah me vëllezërit e tyre. Në malet e Berishës, Divjakës, Kleçkës, Lladrocit

¹ Skender Zhitia, *Organizimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës*, IA, DPASH, ASHAK, Prishtinë, 2022, 226.

² Hanëmsaha Ilazi, *"Atdheu - nënë Bija dhe familja (monografi për Bije Vokshin)"*, Prishtinë, 2012, 20.

dhe në shtabet e njërive të Brigadës 121 dhe 122 të UÇK-së, vajzat dhe gratë kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm. Ato kanë luftuar në frontin e betejave me forcat serbe, kanë kryer shërbime logjistike të rëndësishme për bashkëluftëtarët e tyre dhe kanë ofruar ndihmë mjekësore për të plagosurit. Pjesëmarrja dhe sakrifica e tyre kanë qenë një shembull i vërtetë i guximit dhe i vendosmërisë në mbrojtje të lirisë dhe të pavarësisë së Kosovës.³

Duhet potencuar faktin se Fatmire Zogu nga trevat pranë Llapushës ishte një nga luftëtarët e para të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ajo ishte bashkëveprimtare dhe tani bashkëshortja e themeluesit dhe e drejtuesit të UÇK-së, Nait Hasanit. Roli i saj ishte i jashtëzakonshëm në bashkëngjitjen e luftës për liri të shumë vajzave nga zona e Drenicës, Llapusha, Llapi, Dukagjini dhe viset e tjera të Kosovës. Kontributi i Fatmire Zogut në organizimin dhe motivimin e grave për të marrë pjesë në luftën kundër regjimit serb ishte thelbësor dhe ka lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë e Kosovës. Roli dhe sakrifica e saj janë një testament i guximit dhe i vendosmërisë.

Me rastin e dhënies së betimit solemn të luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në malet e Kleçkës, si korrespondent i luftës kam pasur rastin të takoj shumë vajza të familjeve me tradita atdhetare nga trevat e Llapushës si dhe nga trevat e tjera të Kosovës. Njëra prej tyre që duhet të veçohet është Shkëndije Zogu, e njohur me pseudonimin luftarak “Besa”. Së bashku me Nexhmi Krasniqin, ngritën flamurin kombëtar gjatë ceremonisë së betimit solemn në Kleçkë.⁴ Njëpër fshatra si Kleçka, Luzhnica, Fshati i Ri, Lladroci dhe në vende të tjera të Llapushës, kam takuar edhe disa bashkëluftëtare të Shkëndijes nga kjo trevë, si dhe nga trevat e tjera të vendit tonë. Disa prej tyre janë: Velvetie Sherif Krasniqi-Zogaj nga Drenoci i Malishevës, Nerxhivane Shaban Krasniqi nga i njëjti fshat, Shqipe Krasniqi e Shpresa Krasniqi nga Terpeza, Bukuriye Arif Zogaj nga Lladroci, pastaj Shefkije Zogaj nga Komarani, Xhemile Jasharin nga Prekazi, Fidajete Spahiun nga Drenica dhe shumë të tjera. Kontributi dhe sakrifica e tyre në luftën për liri dhe pavarësi të Kosovës është tejet i madh. Kontributi i tyre është një testament i guximit dhe i përkushtimit, ku ato ishin frymëzim për të gjitha gratë e tjera.⁵

³ Nuhi Bytyçi, *Libri i luftës*, Prishtinë: Armagedoni, 2019, 260.

⁴ Bytyçi, *Libri i luftës...*, 648.

⁵ Informata nga Shtabi i Brigadës 121 të UÇK-së.

Më pas Rajmonda Rrecin nga Llausha e Skënderajt, Valbona Morinën nga Tersteniku i Pejës, Merita Mazrekun nga Prizreni, Hasime Mazreku-Krasniqi nga Malisheva, Hava Zogaj, Shpresa Bekolli, Vezire Buçaj, kurse Hida Buçaj ka marrë pjesë në betejat e Brigadës 138 të UÇK-së në Koshare. Nga fshati Llapushnik në njësitet e UÇK-së kanë qenë të angazhuara në mënyrë aktive edhe Makfire Thaçi dhe Mexhide Thaçi, ndërsa kontribut në mbështetjen e luftëtarëve të lirisë kanë dhënë të gjitha nënat dhe vajzat e këtij fshati dhe të fshatrave tjera të trevës së Llapushës.⁶ Treva e Llapushës ka dhënë edhe shumë figura të jashtëzakonshme të luftës për liri e pavarësi. Ndër luftëtarët e para të UÇK-së ka qenë Xhevë Krasniqi-Lladrovci, nga Drenoci i Malishevës. Ajo bashkë me bashkëshortin e saj, bashkëluftëtarin e idealit, komandantin Fehmi Lladrovcin, mori pjesë në shumë beteja frontale kundër forcave serbe në Drenicë. Pra, Xhevë Krasniqi-Lladrovci është një figurë e rëndësishme në histori, kontributi i saj në luftë është tejet i madh, ngase guximi kundër forcave serbe, për lirinë e Kosovës ishte tejet i madh.⁷ Xheva ka luajtur një rol të rëndësishëm në përfshirjen dhe ushtrimin e një numri të vajzave dhe grave shqiptare në luftën si në organizimin dhe mobilizimin e grave dhe vajzave shqiptare në luftë. Përveç kësaj, Xhevë Krasniqi-Lladrovci ka luajtur një rol udhëheqës në betejat frontale në Drenicë dhe në zona të tjera të Kosovës.⁸

Në cilësinë si korrespondent i luftës, kam pasur fatin të takoj Xhevën në dy raste të ndryshme gjatë periudhës së luftës në Kosovë. Takimi i parë ka ndodhur në fshatin Abri e Epërm, një zonë që ishte e përfshirë në luftimet. Në këtë takim, pata mundësinë të mbledh informacione për zhvillimet në terren. Ndërsa, takimi i dytë ka ndodhur në Shkabë të Drenasit. Gjatë këtij takimi, kam pasur rastin të dëgjoj përvojat dhe strategjitë e tyre në luftë, duke më dhënë një perspektivë të qartë mbi angazhimin e tyre në kauzën për liri.⁹ Rënia e Xhevës dhe bashkëshortit të saj, komandant Fehmi Lladrovcin, më 22 shtator të vitit 1998 ishte një humbje e madhe për luftën në Kosovë. Ata u bënë simbol i guximit dhe i përkushtimit të luftëtarëve për të

⁶ Informata nga Shtabi i Brigadës 121 të UÇK-së.

⁷ Hanëmsaha Ilazi, *Gra të njohura të trojeve shqiptare*, (Prishtinë: Koha, 2015), 11.

⁸ <https://www.radiokosovaelire.com/xheve-avdyll-krasniqi-lladrovci-1-6-1955-22-9-1998-2/> vizituar më: 02.04.2023

⁹ Nuhi Bytyçi, *Kujtime personale nga periudha e luftës së UÇK-së 1998-1999*.

arritur qëllimin. Këta dy luftëtarë u bënë shembull i unitetit dhe i vendosmërisë për të vazhduar përpara në rrugën drejt lirisë së plotë për popullin e Kosovës. Rënia e tyre u bë një motiv për të gjithë ata që vazhduan luftën, duke u shtyrë përpara me guxim dhe përkushtim deri në çlirimin përfundimtar të Kosovës.¹⁰

Vajzat dhe gratë shqiptare dhe angazhimi i tyre në mbrojtje të kombit dhe familjes u tregua në mënyrë të veçantë gjatë periudhës së luftës për liri dhe pavarësi. Ato u vunë në krye të kujdesit për fëmijët duke përballuar rreziqet e shumta të luftës për të siguruar ushqim dhe siguri për të dashurit e tyre. Nënata dhe motrat shqiptare, me guxim dhe vendosmëri, rrezikonin për të siguruar ushqim dhe veshmbathje për fëmijët e tyre dhe për luftëtarët që po luftonin për lirinë e vendit nga pushtuesi shekullor serb. Në këtë kontekst, çdo shtëpi dhe familje shqiptare në Llapushë shërbeu si një qendër e rëndësishme dhe shtab i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Gratë, nënata dhe motrat, me përkushtimin e tyre të pandashëm, ishin pjesë aktive e logjistikës së nevojshme për mbështetjen e luftës për liri duke u dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm për përmbushjen e synimeve tona kombëtare.¹¹

Në fshatin tim të lindjes në Shkozë të Malishevës, të gjithë banorët, të rinjtë, pleqtë, gjyshet, nënata, bashkëshortet dhe motrat e Shkozës ishin në shërbim të plotë të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Energjia e gruas shqiptare, e cila në kulturën tonë nuk ka marrë gjithmonë vlerësimin e duhur, por gjatë luftës së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, u dëshmuar të jetë burim qëndrese. Nënata, nusët dhe motrat shqiptare kanë dëshmuar se janë të barabarta me burrat në guxim dhe vullnet për të luftuar për atdheun e tyre. Kjo vepër e tyre konfirmon se gruaja shqiptare, me përkushtimin dhe vendosmërinë e saj, e meritoan plotësisht besimin dhe respektin. Përpjekjet dhe sakrificat e tyre në luftën për liri, si gjatë historisë së lashtë ashtu edhe në luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, janë një shembull i lartë për lartësimin e identitetit dhe vlerave të kombit shqiptar. Gratë shqiptare kanë lartësuar kombin tonë me guximin dhe përkushtimin e tyre në kohëra të vështira dhe merituan përkrahjen dhe admirimin tonë të përhershëm.

¹⁰ Bytyçi, *Libri i luftës...*, 336.

¹¹ Informata nga Shtabi i Brigadës 121 të UÇK-së.

Gratë e Llapushës dhe kontributi i tyre në shtetndërtimin e Kosovës

Që nga përfundimi i luftës në Kosovë e deri më tani, gratë e trevës së Llapushës, veçanërisht ato të komunës së Malishevës, kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në rindërtimin dhe zhvillimin e shtetit të ri të Kosovës. Komuna e Malishevës, me një popullsi prej mbi 70 000 banorëve, ka shfaqur një vullnet të fortë për të përfshirë gratë në procesin e rindërtimit dhe zhvillimit të vendit. Nga ky numër, rreth 54 000 janë rezidentë të përhershëm të komunës. Nga kjo popullsi rezidente, mbi 53% janë vajza dhe gra, që tregojnë një pjesëmarrje të rëndësishme të tyre në jetën shoqërore dhe ekonomike të komunitetit. Në veçanti, prej tyre, pothuajse $\frac{1}{4}$ janë vajza dhe gra të arsimuara dhe të afta për punë, duke treguar një potencial të madh për të kontribuar në sfidat dhe mundësitë e zhvillimit të vendit. Përfshirja e tyre në procesin e rindërtimit dhe zhvillimit të Kosovës pas luftës ka qenë thelbësore për të siguruar një shoqëri më të barabartë dhe një të ardhme më të ndritur për të gjithë qytetarët. Kjo pjesëmarrje e grave është një shembull i fuqishëm i përkushtimit të tyre ndaj vendit dhe vullnetit për të kontribuar në qytetarinë dhe prosperitetin e Kosovës.¹²

Një numër i konsiderueshëm i grave kanë qenë dhe janë pjesë aktive e punës së institucioneve të Kosovës së re. Pjesa e tyre ka shërbyer në pozicione të rëndësishme dhe të ndryshme duke dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në zhvillimin e vendit. Shumë prej tyre kanë qenë këshilltaret e Kuvendit të komunës së Malishevës, drejtore të administratës lokale, deputete, anëtare të kabinetit të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe pjesë e institucioneve tjera të Kosovës. Ato gjithashtu kanë qenë menaxhere të shumë bizneseve dhe organizatave joqeveritare. Përmes angazhimit të tyre në këto pozita, gratë kanë kontribuar në promovimin dhe përparimin e proceseve demokratike dhe shoqërore në vend. Pjesëmarrja e tyre aktive në jetën politike, ekonomike dhe shoqërore ka ndihmuar në ndryshimin dhe përmirësimin e situatës së përgjithshme në Kosovë, duke kontribuar në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe të barabartë për të gjithë

¹²https://askdata.rksgov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata__Census%20population__Census%202011__3%20By%20Settlements__30%20Popullsia%20e%20komun%c3%ab%20s%20c3%ab%20Malishev%c3%ab%20sipas%20vendbanimit/censusetn30.px/table/tableViewLayout1/

qytetarët. Kjo vazhdon të jetë një shembull frymëzues i përkushtimit dhe i aftësive të grave në vend.

Zyrtarja e Zyrës për Barazi Gjinore (ZBGJ) në Komunën e Malishevës, Vera Bytyçi, së bashku me udhëheqësen e grupit të grave në Kuvendin e Komunës së Malishevës, Hidajete Mazreku, kanë luajtur një rol kyç në promovimin e të drejtave të grave dhe në ndërtimin e një shoqërie më të barabartë në këtë komunë. Me mbështetjen e udhëheqjes së kësaj komune, ato kanë arritur të koordinojnë dhe të ndihmojnë shumë projekte të grave në fushat e arsimit, shëndetësisë dhe projekteve të organizatave qeveritare duke përmirësuar pozitën dhe të ardhmen e grave në shoqërinë tonë.

Në mesin e grave të shquara dhe aktive të kësaj komune, përmenden: humanistja e shquar nga Llapusha, Sanije Desku; veteranes së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hava Zogaj; përfaqësuesja e Organizatës Joqeveritare “Femrat e Llapushës”, Zade Zogaj. Pastaj, Sadije Thaçi, profesoresha Bukurie Mazreku, arsimtarja Sahadete Hoxha-Gashi, afaristja Zojë Telaku dhe shumë gra tjera nga kjo trevë. Kontributi dhe përkushtimi i tyre në promovimin e barazisë gjinore dhe zhvillimin e komunitetit është një shembull frymëzues për të gjithë shoqërinë dhe tregon për forcën dhe kapacitetet e grave për të ndryshuar dhe përparuar në shoqërinë.¹³ Përndryshe, rajoni i Llapushës ka dhënë një numër të madh emrash të shquar në fushën e artit, kulturës dhe arsimit. Një nga figurat më të shquara është Nexhmije Pagarusha*, e cila është një artiste e madhe dhe e nderuar në të gjithë hapësirën shqiptare dhe më gjerë.

¹³ Buletini i Zyrës për Barazi Gjinore në Malishevë, 2021.

* Nexhmie Pagarusha ishte një këngëtare dhe aktore shqiptare. Ajo u njoh si mbretëresha e muzikës shqiptare. Lindi më 7 maj 1933 në fshatin Pagarushë, pranë qytetit Malisheva në Kosovë. Karriera e saj muzikore zgjati përreth 40 vjet dhe për shkak të kontrastit të zhanreve që ajo performoi, nuk është e lehtë të përcaktohet se çfarë lloj këngëtareje ishte. Ajo këndoi si muzikë popullore ashtu edhe muzikë klasike, veçanërisht opera. Nexhmie Pagarusha u njoh me tituj, si *Bilbili i Kosovës*, *Mbretëresha e muzikës kosovare* dhe *Madame Butterfly*. Ajo performoi jo vetëm në vendin e saj, por edhe në vende të tjera të Evropës, si Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Bosnjë-Hercegovina, Bullgaria etj. Ajo udhëhoqi disa turne me ansamblin muzikor Shota në këto vende si dhe në Izrael. Në Kosovë, ajo fitoi titullin e *Këngëtares së Shekullit*. Një nga këngët e saj më të njohura është “Baresha”. Kjo këngë u kompozua nga burri i saj, Rexho Mulliq, dhe teksti u shkrua nga Rifat Kukaj. Nexhmie Pagarusha luajti në shumë drama teatrale dhe filma dhe si aktore fitoi shumë çmime. Ajo mbylli karrierën e saj muzikore në

Nexhmije Pagarusha ka lënë gjurmë në skenën muzikore shqiptare me interpretimet e saj. Ajo ishte një ikonë e muzikës tradicionale shqiptare dhe ka shfaqur talentin dhe pasionin e saj nëpër shumë skena të ndryshme, duke frymëzuar brezat e rinj dhe duke promovuar trashëgiminë kulturore shqiptare. Përveç kontributeve në fushën e muzikës, Nexhmije Pagarusha ka qenë gjithashtu një mbështetëse e arsimit dhe kulturës në rajonin e Llapushës dhe më gjerë. Përfaqësoi një shembull frymëzues për të rinjtë dhe për të gjithë komunitetin, duke treguar se talenti dhe pasioni mund të çojnë në sukses të madh duke shërbyer si një burim frymëzimi për brezat e ardhshëm.

Po i përmendim vetëm disa nga veprimtarët e trevës së Llapushës, të cilat kanë dhënë kontribut të rëndësishëm në periudhën e rindërtimit të Kosovës së lirë e të pavarur: Hidajete Mazreku, ish-deputete e Kuvendit të Kosovës, e njohur për përkushtimin e saj në politikë dhe përfaqësimin e interesave të qytetarëve; Arbëreshë Krasniqi, ish-deputete, ish-zv. ministre dhe drejtoreshë e arsimit në komunën e Malishevës. Kontributi i saj në fushën e arsimit është i vyer; Shukrije Hajdin Bytyçi, profesoreshë e kimisë në shkollën e mesme në Malishevë dhe ish-deputete e Kuvendit të Kosovës. Përkushtimi i saj për arsimin dhe përparimin e shoqërisë është i vlerësuar gjerësisht; Besarta Kryeziu-Rama, ish-drejtoreshë e Kulturës në Malishevë. Kontributi i saj në promovimin e kulturës dhe të trashëgimisë kulturore ishte i rëndësishëm; Heroina Telaku, diplomate dhe ambasadore e Kosovës në Panama dhe Honduras. Përprjekjet e saj për të përfaqësuar vendin në arenën ndërkombëtare janë të admirueshme; doktoreshë e shkencave Albana Kashtanjeva-Bytyçi,¹⁴ mësimdhënëse në Universitetin e Prishtinës. Kontributi i saj në fushën

vitin 1984, pas një koncerti të madh në Sarajevë. Në vitin 2000, pas 16 vjetësh largim, ajo këndoi këngën “Për ty” në një emision televiziv shqiptar. Gjithashtu, ajo punoi si këshilltare e lartë për muzikën në Radio Kosovë dhe Radio Blue Sky në Prishtinë. [Në nëntorin e vitit 2012, ajo u dekorua me Nderin e Kombit nga presidenti Shqipërisë, Bujar Nishani.](#) Makedonska krvava svadba, Albanian: Dasma e përgjakur, Bloody Wedding (1967) as Nedžmije Pagaruša. “Biografia: Nexhmije Pagarusha”. Archived from the original on 10 July 2015. Retrieved 12 October 2013; “Nderi i Kombit”, Nexhmije Pagarusha [“Honor of the Nation”, Nexhmije Pagarusha] (in Albanian), Gazeta Express, 29 November 2012, archived from the original on 3 November 2013, retrieved 4 November 2013.

¹⁴Albana Kashtanjeva-Bytyçi, Department of Biology, Faculty of Mathematical and Natural Sciences, University of Prishtina, St. Mother Teresa, 10 000 Pristina, Republic of Kosovo.

e arsimit dhe të kërkimit shkencor është i rëndësishëm; Ibadete Bytyçi,¹⁵ doktoreshë e Shkencave të Mjekësisë, kardiologe. Kontributi i saj në mjekësi dhe në promovimin e shëndetit publik është i çmuar; Afërdita Bytyçi, gjyqtare dhe ish-kryetare e Gjykatës Themelore të Prishtinës. Përpjekjet e saj për të siguruar drejtësi dhe sundimin e ligjit janë të rëndësishme për zhvillimin e shtetit të ligjit në Kosovë; Arbëri Njazi Bytyçi, master i Ekologjisë. Kontributi i saj në ruajtjen e mjedisit dhe në zhvillimin e trajtimit të mbeturinave është i vlerësuar gjerësisht.

Këto janë vetëm disa prej shembujve të veprimtarëve të rëndësishëm nga treva e Llapushës, të cilët kanë kontribuar në rindërtimin dhe zhvillimin e Kosovës së lirë dhe të pavarur. Kontributi i tyre është i çmuar dhe vlerësohet gjerësisht nga shoqëria. Pra, kontributi i vajzave dhe grave të trevës së Llapushës, sidomos i intelektualeve të reja bashkë me vajzat dhe gratë e trevave tjera në ndërtimin e Kosovës së re, shtet i pavarur e demokratik po vazhdon në forma të ndryshme.

Duke u mbështetur në burime të ndryshme si dokumente historike të kohës, literaturën shkencore dhe raporte publike, si dhe në përvijën time personale, në këtë studim kam trajtuar rolin dhe kontributin e grave të Llapushës gjatë periudhës së luftës për lirinë e Kosovës. Lufta çlirimtare e popullit të Kosovës në vitet 1998-1999, e drejtuar nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK), është një kapitull i rëndësishëm në historinë e kombit shqiptar. Kjo luftë u ngrit për të mbrojtur të drejtat dhe lirinë e popullit shqiptar në Kosovë dhe u konsiderua si një përgjigje e nevojshme ndaj dhunës dhe shtypjes së regjimit serb dhe pa dyshim që kontributi i gruas në këtë luftë ishte tejet i madh. Në këtë studim, përveç trajtimit të kësaj periudhe të rëndësishme historike, kam evidentuar rolin dhe kontributin e grave të Llapushës, veçanërisht atyre nga komuna e Malishevës, në procesin e rindërtimit dhe zhvillimit të Kosovës pas luftës.

¹⁵ Ibadete Bytyçi, MD, PhD, FESC Clinic of Cardiology, University Clinical Centre of Kosovo, Republic of Kosovo, Dr. Bytyçi's clinical and research focus are the left atrium function, anticoagulation in paroxysmal atrial fibrillation, dyslipidemia, coronary artery disease and preventive cardiology. She published and presented her works in many national and international cardiovascular conferences on these topics.

Gratë e trevës së Llapushës kanë luajtur një rol të jashtëzakonshëm në këtë proces, duke kontribuar në shumë fusha të jetës publike dhe private, duke filluar nga arsimi, shëndetësia, drejtësia, dhe kultura. Përpyekjet e tyre janë vlerësuar si thelbësore për rindërtimin dhe përparimin e shoqërisë kosovare në periudhën e pas luftës.